

RELACIONI TEKNIK MBI VLERËSIMIN E RISKUT

Kisha e Manastirit të Shën Mërisë së Spilesë

Objekt kulti, Kategori I-rë

Fshati Tranoshishtë, Gjirokastrë.



1. Hyrje	2
2. Përshkrimi i kompozimit Arkitektonik	2
3. Muratura	3
4. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese	3
5. Konkluzione	3

1. Hyrje

Ky relacion hartohet nga DRTK - Gjirokastër pas inspektimit të gjendjes me datë 04.09.2024, për të verifikuar gjendjen e objektit pas projektit të hartuar para një viti. Siç shihet nga fotot e meposhteme objekti nuk ka pasur ndryshime nga koha e hartimit të projektit. Konstruksioni, catia dhe gjithë elementet e ndertesës janë në gjendje të qëndrueshme, duke iu referuar vitit të kaluar. Për këtë arsye kërkojmë rimiratimin e projektit për të gjetur mundësinë e financimit si nga IKTK-ja, DRTK Gjirokaster ose nga fondet e projektit IPAR 2, për të cilat kemi aplikuar.

2. Përshkrimi i kompozimit arkitektonik

Përbëhet nga naosi i pikturuar në vitin 1634 nga Mihali (i cili duhet të jetë Mihali nga Linotopi), narteksi i pikturuar në vitin 1659 dhe një portik përpara hyrjes së narteksit në anën jugore. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë, me përmasa të brendshme 7,40x6,20 m. Kompozimi planimetrik, zgjidhja konstruktive dhe formulimi i jashtëm arkitektonik ndryshojnë shumë pak nga ato të kishës që ndodhet në fshat, gjë që, duke patur parasysh dhe kohën e njëjtë të ndërtimit, na shtyn të mendojmë se të dy kishat do të jenë ndërtuar nga të njëjtët mjeshtra. Kollonat e brendshme lidhen ndërmejt tyre dhe me muret perimetrale me harqe në të dy drejtimet duke formuar bërthamën qendrore katrore, të mbuluar me kupolë mbi tambur dhe katër krahët e kryqit, të mbuluar me qemere cilindrike. Cifti lindor i pjesëve këndor mbulohet me kësule sferike, ndërsa ai perëndimor me qemere me prerje çerekrrethore. Kisha ndriçohet nga dritaret e tamburit dhe ato të hapura në muret verior dhe jugor. Në anën perëndimore naosi lidhet me narteksin, i cili mbulohet nga një qemer gjatësor në pjesën qendrore, i ngritur mbi dy qemere tërthore, në pjesët anësore. Hyrja nga jugu mbrohet nga një portik i hapur në tri anë me harkada, që formojnë një bërthamë katrore të mbuluar me kupolë. Kisha është e suvatuar nga jashtë, por suvatimi nuk i ka rrafshuar relievet e krijuara në apsidë dhe në tambur. Tamburi tetëfaqësh përmban katër dritare, të alternuara me faqe të plota e të rrafshta. Muratura e tamburit përfundon me një kornizë të fuqishme, të përbërë nga tri rradhë në formë dhëmbësh sharre. Apsida pesëfaqëshe përmban nike të vogla në pjesën e vendosur në formë dhëmbësh sharre.

3. Muratura





Kisha është e ndertuar rreze malit me gure të radhes ,e mbuluar me cati me rasa guri. Kisha është e suvatur nga jashtë, por suvatimi nuk i ka rrafshuar relievet e krijuara në apsidë dhe në tambur. Tamburi tetëfaqësh përmban katër dritare, të alternuara me faqe të plota e të rrafshata. Muratura e tamburit përfundon me një kornizë të fuqishme, të përbërë nga tri rradhë në formë dhëmbësh sharre



4. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese

Ka një kohë të konsiderueshme që në këtë objekt nuk është bërë ndonjë rikonstruksion. Si rezultat i kësaj, objekti ka problem në qëndrueshmëri, cati, në pjesën e hyrjes dhe në pikturat murale. Gjithashtu, ka nevojë për pastrime dhe ringritjen e një pjese të mureve rrethues. Projekti në fjalë i përmbush kërkesat tuona për restaurimin e këtij objekti.

5.Konkluzione

Sic shihet nga fotot e mëposhteme objekti nuk ka pasur ndryshime nga koha e hartimit të projektit. Konstruksioni, catia dhe gjithë elementet e ndërtesës janë në gjendje të qëndrueshme, duke iu referuar vitit të kaluar.





Ing. Vasil POLO

Vasil
Polo



Digitally signed by Vasil Polo
Date: 2024.09.01
+02'00'

Sokol
Ismaili

Digitally signed by
Sokol Ismaili
Date: 2024.10.04
13:12:34 +02'00'



DREJTOR

Ing. Ardis DUKA

